

## **Deklarata e Mijëvjeçarit dhe Shqipëria.**

Samitet dhe Konferencat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara të mbajtura gjatë viteve 1990-të kanë adresuar çështje globale shoqërore, ekonomike dhe mjedisore me të cilat përballen si vendet e zhvilluara edhe ato në zhvillim. Konventat dhe deklaratat përkatëse u sintetizuan në Deklaratën e Mijëvjeçarit, e cila u miratua në shtator të vitit 2000 në Samitin e Mijëvjeçarit, ku mori pjesë edhe Presidenti shqiptar, zoti Rexhep Meidani krahas 147 kryetarëve të shteteve dhe qeverive të botës. Në Deklaratë shtetet shprehin angazhimet e tyre në drejtim të paqes, sigurimit, zhvillimit, përfshirë fushën e mjedisit, të drejtat e njeriut dhe qeverisjes.

Në kuadrin e kësaj deklarate janë përfshirë edhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (Millennium Development Goals) të cilat janë:

1. Eliminimi i varfërisë ekstreme dhe i urisë;
2. Arritja e arsimimit parësor universal;
3. Nxitja e barazisë gjinore;
4. Reduktimi i vdekshmërisë foshnjore;
5. Përmirësimi i shëndetit të nënës;
6. Luftimi i sëmundjeve HIV/AIDS, malarjes etj;
7. Sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit;
8. Zhvillimi i një partnerशिpi global për zhvillimin.

Tetë objektivat e mësipërm janë të ndarë në 18 nën-objektiva (targets), si dhe 48 indikatorë të posaçëm. Në bazë të këtyre objektive janë marrë disa angazhime për realizimin e të cilave si afat kohor është vendosur periudha 1990-2015. Mënyra e zbatimit të këtyre angazhimeve nga secili vend anëtar i OKB-së është objekt monitorimi nga OKB. Kjo e fundit duhet të raportojë periodikisht për sa më sipër si në nivel global ashtu dhe për çdo vend të veçantë. Në procesin e raportimit është përfshirë edhe UNDP (zyrat përkatëse në çdo vend ku UNDP ushtron aktivitetin).

## **Roli i Shqipërisë dhe MPJ-në në veçanti në Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarit (MDG).**

Shqipëria si një nga vendet që ka nënshkruar Deklaratën e Mijëvjeçarit është shprehur e gatshme për të plotësuar angazhimet që rrjedhin prej saj, të përcaktuara tek Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarit, të cilat janë përfshirë në programin e Qeverisë shqiptare, si dhe në strategjitë e ndryshe të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

Institucionet shtetërore shqiptare janë të angazhuara për të zbatuar sipas fushave që mbulojnë Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarit, krahas zbatimit të detyrimeve dhe angazhimeve që rrjedhin në kuadrin e akteve të miratuara nga konferencat ndërkombëtare në të cilat kemi marrë pjesë.

Në muajin maj 2002 u botua raporti i parë me titull “Shqipëria dhe Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarin” i përgatitur në mënyrë të pavarur nga një organizatë jo-qeveritare me mbështetjen e UNDP në Tiranë.

Një rol të veçantë në këtë proces i takon të luajë MPJ, përmes Sektorit të Raportimeve për Konventat Ndërkombëtare pranë Drejtorisë së OKB-së. Ky sektor ka për detyrë përgatitjen e raporteve kombëtare mbi konventat e OKB-së për të drejtat e njeriut ku Shqipëria është pale, përfshirë fillimin e raportimeve periodike edhe për zbatimin e Objektivave për Zhvillimit e Mijëvjeçarit.

UNDP, institucionet shtetërore, përfshirë MPJ-në dhe shoqëria civile po punojnë për arritjen e një konsensusi kombëtar për MDG-të, zgjerimin e pjesëmarrjes me partnerë të ndryshëm kombëtarë dhe cilësinë e dialogut, marrjen gradualisht të pronësinë të Qeverisë Shqiptare të këtij procesi dhe strategjinë e përhapjes dhe të advokimit të tij, etj.